



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 39, datë 03.03.2025

PËR

“TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/Kryetar
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zoti Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 03.03.2025, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Transferim të përkohshëm me pëlqim”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim, relacionin shoqërues nr. 259 prot., datë 12.02.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi relatorin zotin Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

LAKE SHORE
STATE PROPERTY



V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli), në bazë të nenit 149 të Kushtetutës, është institucioni që garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.
2. Me urdhrin nr. 19, datë 30.01.2024, "Për strukturën organike të prokurorive të shkallës së parë dhe prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm" të ndryshuar, Prokurori i Përgjithshëm ka përcaktuar numrin prej 90 prokurorësh në zyrën e prokurorisë Tiranë. Ndërkohë me Urdhrin nr. 61, datë 13.05.2024, Për një ndryshim të Urdhërit nr. 19, datë 30.01.2024 "Për strukturën organike të prokurorive të shkallës së parë dhe prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", Prokurori i Përgjithshëm ka shkurtuar një vend në organikën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me numër total 89 prokurorë në këtë zyrë prokurorie.
3. Aktualisht, në këtë zyrë ka gjithsej 39 vakanca, 21 prej tyre të përkohshme, vendim pezullimi nga KPK, për shkak të komandimeve në KLP, PP dhe ILD, si dhe 18 vakanca të përhershme.
4. Referuar sa më lart si dhe më qëllim plotësimin e vakancave në fjalë, drejtuesi i zyrës së prokurorisë Tiranë, ka parashtruar kërkesë pranë Këshillit për plotësim të organikës, për shkak se aktualisht prokurorët në këtë zyrë kanë ngarkesë të konsiderueshme në numër çështjesh për secilin prej tyre.
5. Kërkesa e lartpërmendur, u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit, në raport me parashikimet në legjislacionin në fuqi, si dhe ngarkesën në numër çështjesh të zyrave të tjera të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.
6. Ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nënin 42 ka parashikuar parimet e transferimit, ku në pikën 2 parashikohet: "Transferimi bëhet në një pozicion të lirë të përhershëm ose të përkohshëm. Pozicioni është i lirë në mënyrë të përhershme vetëm nëse nuk ka magjistratë me të drejtën për t'u kthyer në atë pozicion. Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion", ku nga ana e Komisionit dhe në vijim Këshilli kanë aplikuar këto parime, lidhur me procedurën e transferimit të përkohshëm me pëlqim.
7. Nga ana e Këshillit është marrë në analizë parashikimi ligjor i nenit 46 "Transferimi i përkohshëm", të ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili sanksionon kriteret dhe rregullat procedurale lidhur me këtë mekanizëm të plotësimit të vakancave.

Konkretisht pika 1 e këtij neni parashikon:

1. Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm, Këshilli mund t'i kërkojë magjistratit në një nga gjykatat ose prokuroritë me ngarkesën më të



ulët, i cili përmbush kriteret për t'u transferuar ose për t'u ngritur në detyrë në pozicionin përkatës, të japë pëlqimin që për një periudhë të caktuar të transferohet përkohësisht në atë pozicion. Në këtë rast, Këshilli merr paraprakisht mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë ku ushtron funksionin magjistrati. [...]

8. Lidhur me transferimin e përkohshëm, si akt nënligjor është miratuar Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, ku në nenin 5 të saj parashikohen, “Parimet dhe kriteret e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, të cilat përkufizojnë kriteret dhe rregullat procedurale lidhur me këtë mekanizëm ligjor të plotësimit të vakancave.
9. Në zbatim të nenit 4 gërma “dh”¹ të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, është kërkuar informacion nga Prokuroria e Përgjithshme në lidhje me ngarkesën e të gjitha prokurorive të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm.
10. Është ezauruar gjithashtu, marrja e mendimit të drejtuesve të zyrave të prokurorisë nga zyrat e prokurorive që rezultojnë me ngarkesën më të ulët.
11. Nga informacioni i administruar nga Prokuroria e Përgjithshme, ngarkesa më e ulët është ajo e zyrave të prokurorive: Lezhë, Dibër, Kukës, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë, Korçë, Fier, Berat dhe Sarandë.
12. Gjithashtu, nga këto zyra prokurorie të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, nga ana e Relatorit nuk janë përfshirë zyrat e prokurorive si vijon:
 - Shkodër pasi Këshilli i ka marrë dy prokurorë që i ka transferuar përkohësisht në zyrën e prokurorisë Elbasan;
 - Gjirokastrë pasi gjithashtu, Këshilli ka marrë një prokuror që e ka transferuar përkohësisht në zyrën e prokurorisë Fier;
 - Fier, Këshilli ka transferuar përkohësisht një prokuror nga prokuroria e Gjirokastrës;
 - Vlorë, pritet të largohet Vitjuna Mata si rezultat i procedurës së lëvizjes paralele.
13. Në rrugë elektronike janë administruar përgjigjet e prokurorëve, të cilët konfirmojnë dhënien e pëlqimit për transferimin e tyre në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për një periudhë 1 vjeçare, sipas listës më poshtë:
 1. Albjona Papajani, prokuror në zyrën e prokurorisë Berat;
 2. Arbër Delilaj, prokuror në zyrën e prokurorisë Korçë;
 3. Arisa Shkrepi, prokuror në zyrën e prokurorisë Korçë;
 4. Blerta Hamza, prokuror në zyrën e prokurorisë Shkodër;
 5. Briselda Zhuzhi, prokuror në zyrën e prokurorisë Korçë;

¹ “Prokuroria me ngarkesë më të ulët” nënkupton zyrën prokurororët e së cilës kanë ngarkesën më të ulët referuar të dhënave zyrtare më të fundit të Prokurorit të Përgjithshëm.



6. Denisa Perdja, prokuror në zyrën e prokurorisë Lezhë;
7. Drini Zeqo, prokuror në zyrën e prokurorisë Dibër;
8. Ema Lazaj, prokuror në zyrën e prokurorisë Lezhë;
9. Enea Babameto, prokuror në zyrën e prokurorisë Korçë;
10. Enkeleda Hoxha, prokuror në zyrën e prokurorisë Kukës;
11. Enkelejda Meçka, prokuror në zyrën e prokurorisë Korçë;
12. Erida Visoçi prokuror në zyrën e prokurorisë Vlorë;
13. Esmeranda Basho, prokuror në zyrën e prokurorisë Sarandë;
14. Françesk Ganaj, prokuror në zyrën e prokurorisë Lezhë;
15. Griselda Haxhiaj, prokuror në zyrën e prokurorisë Kukës.
16. Irena Sufaj, prokuror në zyrën e prokurorisë Lezhë;
17. Iva Harka, prokuror në zyrën e prokurorisë Lezhë;
18. Klerta Çonga, prokuror në zyrën e prokurorisë Korçë;
19. Lediana Shkurti, prokuror në zyrën e prokurorisë Korçë;
20. Matilda Fetahu, prokuror në zyrën e prokurorisë Lezhë;
21. Nertila Bregu, prokuror në zyrën e prokurorisë Lezhë;
22. Odeta Todorushi, prokuror në zyrën e prokurorisë Lezhë;
23. Olta Hadushaj, prokuror në zyrën e prokurorisë Lezhë;
24. Renato Tosku, prokuror në zyrën e prokurorisë Berat;
25. Vasjana Postoli, prokuror në zyrën e prokurorisë Korçë;
26. Vilma Kapaj, prokuror në zyrën e prokurorisë Kukës;
27. Vitjuna Mata, prokuror në zyrën e prokurorisë Vlorë;
28. Xhoana Mehmetaj, prokuror në zyrën e prokurorisë Dibër.

14. Nga lista e mësipërme e prokurorëve që kanë shprehur interesin për transferim, Këshilli ka shqyrtuar propozimin e Relatorit lidhur me kandidaturat e prokurorëve: Françesk Ganaj dhe Matilda Fetahu nga zyra e prokurorisë Lezhë, Griselda Haxhiaj nga zyra e prokurorisë Kukës dhe Ledjana Shkurti nga zyra e prokurorisë Korçë.

- Zonja Ledjana Shkurti është emëruar prokuror dhe është caktuar në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë me vendimin e KLP-së nr.213, datë 27.07.2022;
- Zonja Matilda Fetahu është transferuar në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë me vendimin e KLP-së nr. 82, datë 24.04.2023.
- Zonja Griselda Haxhiaj është emëruar prokuror dhe është caktuar në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës me vendimin e KLP-së nr. 218, datë 27.07.2022;
- Zoti Françesk Ganaj është emëruar prokuror dhe është caktuar në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë me vendimin e KLP-së nr. 582, datë 17.07.2019,

15. Në vijim, si dhe në përmbushje të dispozitës së lartpërmendur që shpreh detyrimin për marrjen e mendimit të drejtuesve gjatë zhvillimit të kësaj procedure, Relatori i çështjes i'u drejtua drejtuesve të zyrave pranë të cilave janë të emëruar prokurorët që kanë shprehur pëlqimin për transferim, për të marrë mendimin e tyre, për një periudhë 1 vjeçare.



16. Nëpërmjet postës elektronike dt. 13.01.2025 (zyra e prokurorisë Korçë) dhe 14.01.2025(zyra e prokurorisë Lezhë), drejtuesit e zyrave respektive kanë shprehur dakordësinë e tyre për transferimin e përkohshëm të prokurorëve në fjalë në zyrën e prokurorisë Tiranë. Drejtuesi i zyrës së prokurorisë Kukës është shprehur se ka konflikt interesi për të dhënë mendim lidhur me sa kërkohej, pasi ka shprehur dhe vetë pëlqimin për këtë procedurë.

17. Pas diskutimeve në komision, anëtarja e Komisionit zonja Ledina Riza nuk ka dhënë dakordësinë lidhur me rrethanat dhe faktet e paraqitura në relacion nga ana e relatorit, pasi procedura e ndjekur prej tij në rastin konkret nuk ka mbajtur në konsideratë parashikimet ligjore dhe proceduriale që ndiqen në këto raste. Me shumicë votash i'u propozua Këshillit që për kandidatët e sipërcituar të aplikohet transferimi i përkohshëm me pëlqim në bazë të nenit 46 pika 1 të Ligjit për Statusin, dhe nenit 10 të rregullores "Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit", për një periudhë një vjeçare.

18. Lidhur me aplikimin për transferim me pëlqim të znj. Enkeleda Hoxha, Komisioni për shkak të mendimit ndryshe të secilit anëtar, la në vlerësim të Këshillit shqyrtimin e kërkesës në fjalë.

Për sa më sipër Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ka vlerësuar se:

19. Në seancën plenare të Këshillit datë 13.02.2025, u morr në shqyrtim çështja dhe në vijim të diskutimeve nga ana e anëtarëve u dakordësua që Relatori, të plotësojë me të dhëna shtesë relacionet e paraqitura për transferimin me pëlqim në zyrat e prokurorisë Tiranë dhe Elbasan, konkretisht sa i takon përditësimit të të dhënave për ngarkesën në punë të të gjitha zyrave të Prokurorive të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm nga Prokurori i Përgjithshëm, vjetërsisë të gjithë prokurorëve të cilët kanë shprehur pëlqimin për t'u transferuar, si dhe mendimin e drejtuesve respektivë të zyrave të prokurorive ku ushtrojnë aktualisht detyrën.

20. Sa më sipër, u përditësuan të dhënat për ngarkesën në punë të të gjitha zyrave të Prokurorive të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, siaps informacionit të përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 270/1 prot, datë 19.02.2025. Volumi i punës për vitin 2024 është si më poshtë vijon:

Prokuroria	Mosfilluar	Mbartur	Regjistruar	Rifilluar		Gjithsej trajtuar çështje	Prokurorë në detyrë	Mesatarja për Prokuror
				Të pushuara	Të pezulluara			
Lezhë	404	686	1207	0	437	2330	11	212
Dibër	332	582	575	0	1	1158	7	223
Kukës	248	320	618	0	253	1191	6	199

HOIPERIS
ROKURO
A-1



Vlorë	496	1824	1493	0	0	3317	15	221
Shkodër	426	723	1831	3	1	2578	11	234
Gjirokastrë	387	856	761	0	0	1617	7	231
Korçë	902	2031	1740	0	20	3791	15	253
Durrës	2038	2235	2583	0	23	4841	18	269
Fier	323	2412	2005	0	14	4431	16	277
Berat	348	1214	741	0	0	1955	7	279
Tiranë	6352	6622	8839	8	86	15555	49	318
Sarandë	530	1199	965	0	0	2164	7	309
Elbasan	805	1676	1563	0	14	3253	9	361

21. Pas përditësimit të të dhënave të parashtruara në tabelën si më lart, u hodhën në votim propozimet sipas Relacionit të paraqitur, si dhe propozimi i zotit Hoda që nga zyra e prokurorisë Dibër të përzgjidhen 2 prokurorë, për transferimin me pëlqim; nga zyrat e prokurorisë Kukës, Lezhë, Vlorë dhe Shkodër të përzgjidhet respektivisht nga një prokuror për transferim me pëlqim) për përzgjedhjen e zyrave të prokurorëve nga të cilat do të përzgjidhen kandidaturat për transferimin me pëlqim².

22. Lidhur me vjetërsinë e prokurorëve që kanë shprehur pëlqimin për transferim, Relatori plotësoi të dhënat dhe ia parashtrori Këshillit.

23. Të dhënat e parashtruara nga relatori i çështjes u konsideruan të plota, lidhur me vjetërsinë në detyrë të prokurorëve që kanë shprehur pëlqimin për transferim, si kriter i shprehur në nenin 5, pika 5, të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, ku parashikohet: “Në rast se ka më shumë se një prokuror që jep pëlqimin për transferim të përkohshëm në një prokurori konkrete, Këshilli vendos të përzgjedhë kandidatin duke marrë në konsideratë përvojën profesionale të prokurorëve dhe çështjet konkrete mbi të cilat është duke punuar”.

² Votimi u krye në mënyrë të veçantë për secilën zyrë prokurorie.

Për zyrën e prokurorisë Berat votuan “pro” propozimit për transferimin e një prokurori me pëlqim, anëtarët: Bogdani, Stojani, Duda, Eminaj dhe Merkuri. Votuan “kundër” anëtarët: Riza, Hoda, Staka, Fejzulla, Mandro dhe Germenji. Propozimi u rrëzua.

Për zyrën e prokurorisë Dibër votuan “pro” propozimit për transferimin e një prokurori me pëlqim, anëtarët: Bogdani, Stojani, Duda, Eminaj, Merkuri, Riza dhe Mandro. Votuan “kundër” anëtarët: Hoda, Staka, Fejzulla dhe Germenji.

Për zyrën e prokurorisë Kukës votuan unanimisht të gjithë antarët për propozimin për transferimin e një prokurori me pëlqim.

Për zyrën e prokurorisë Lezhë votuan “pro” propozimit për transferimin e dy prokurorëve me pëlqim, anëtarët: Bogdani, Stojani, Duda, Eminaj, Merkuri, Germenji dhe Mandro. Votuan “kundër” anëtarët: Riza, Hoda, Staka dhe Fejzulla.

Për zyrën e prokurorisë Korçë votuan “pro” propozimit për transferimin e një prokurori me pëlqim, anëtarët: Bogdani, Stojani, Duda, Eminaj, Merkuri, Germenji dhe Mandro. Votuan “kundër” anëtarët: Hoda, Riza, Staka dhe Fejzulla.

Për zyrën e prokurorisë Vlorë votuan “pro” propozimit për transferimin e një prokurori me pëlqim antarët: Bogdani dhe Merkuri. Votuan “kundër” anëtarët: Bogdani, Stojani, Riza, Duda, Eminaj, Mandro, Fejzulla dhe Germenji. Në mungesë të zotit Hoda. Propozimi u rrëzua.

Për zyrën e prokurorisë Shkodër votuan “pro” propozimit për transferimin e një prokurori me pëlqim, anëtarët: Merkuri, Fejzulla, Germenji dhe Staka. Votuan “kundër” anëtarët: Bogdani, Stojani, Riza, Duda, Eminaj dhe Mandro. Në mungesë të zotit Hoda. Propozimi u rrëzua.



24. Gjithashtu, u përditësuan mendimet e drejtuesve të zyrave të prokurorive lidhur me ngarkesën e zyrës së prokurorisë në tërësi dhe të prokurorit në veçanti (lidhur me çështjet e mbartura për vitin 2025 dhe ngarkesën në punë), numrin total të prokurorëve që ushtrojnë funksionet në prokurori, seksionin ku bën pjesë prokurori, pasojat që mund të ketë në ngarkesën e zyrës së prokurorisë transferimi i mundshëm, si dhe një propozim mbi periudhën maksimale të transferimit të përkohshëm.
25. Këshilli vlerësoi të plota dhe konform nenit 46 “*Transferimi i përkohshëm*”, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të dhënat e përfuara nga mendimet e drejtuesve të zyrave të prokurorive lidhur me ngarkesën e zyrës së prokurorisë në tërësi dhe të prokurorit në veçanti, sa i përket numrit total të prokurorëve që ushtrojnë funksionet në zyrat respektive të prokurorive, seksionin ku bëjnë pjesë, pasojat që mund të ketë në ngarkesën e zyrës së prokurorisë transferimi i mundshëm, si dhe një propozim mbi periudhën maksimale të transferimit të përkohshëm.
26. Pas miratimit të zyrave të prokurorive dhe miratimit të numrit të prokurorëve për secilën zyrë prokurorie që do të transferohen nëpërmjet procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim, u vijua në votimin nominal për secilin prokuror të propozuar.
27. Në lidhje me masën e kompensimit mujor për magistratin që transferohet përkohësisht, neni 15 pika 2 e ligjit nr. 96/2016 i ndryshuar, përcakton se:

[...] Magjistrati në skemën e delegimit, magjistrati i transferuar përkohësisht ose magjistrati i caktuar përkohësisht, kur delegohet, transferohet përkohësisht ose caktohet përkohësisht për një periudhë kohore më të gjatë se periudha e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përfiton një kompensim mujor në masën e jo më shumë se 80 për qind të pagës referuese bazë. Ky kompensim mbulon çdo shpenzim për qëndrimin dhe transportin e magistratit në gjykatën ose prokurorinë ku magjistrati është deleguar, transferuar përkohësisht ose caktuar përkohësisht. [...]
28. Duke qenë se aktualisht, Këshilli me vendimin nr. 386, datë 30.11.2023, ka miratuar Rregulloren për “*Caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë*”, pagesa e prokurorëve që propozohen për t’u transferuar, do të bëhet sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje.
29. Në përfundim, Këshilli lidhur me propozimin për transferimin me pëlqim të prokurorit Ledjana Shkurti, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, në zyrën e prokurorisë Tiranë, Këshilli, mbajti në konsideratë mos cenimin e funksionalitetin e zyrës së prokurorisë Korçë, përshtatshmërinë në zyrën në të cilën prokurori do të transferohet dhe kërkesat e ligjit për plotësimin e kushteve formale për aplikimin e mjetit ligjor “transferim i përkohshëm me pëlqim”, veçanërisht kriterin e vjetërsisë më të madhe midis prokurorëve të zyrës së prokurorisë

QIPERONIS
20KURONIS
TR



Korçës që kanë shprehur pëlqimin për transferim³. Lidhur me afatin e transferimit u dakordësua në unanimitet që ky afat të fillojë nga data 17.03.2025, dhe të jetë një vjeçar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149 pika 1 dhe 149/a pika 1 germa "a", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 46 pika 1, të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a" të ligjit nr.115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*" i ndryshuar, nenit 10 të Rregullores "*Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit*", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,


V E N D O S I:

1. Zonja Ledjana Shkurti, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, transferohet përkohësisht me pëlqimin e saj, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
 2. Zonja Ledjana Shkurti do të ushtrojë detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke filluar nga data 17.03.2025 deri 16.03.2026.
 3. Të njoftohen për këtë vendim zonja Ledjana Shkurti, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
 4. Gjatë periudhës së transferimit zonja Ledjana Shkurti do të përfitojë shtesë mbi pagën referuese bazë, sipas përcaktimeve të vendimit nr.386, datë 30.11.2023, për miratimin e Rregullores për "*Caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë*".
 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.
- U shpall në Tiranë, sot më 03.03.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani



ZV/KRYETAR
Erind Germenji
kundër



³ Lidhur me propozimin e Relatorit mbi transferimin e përkohshëm me pëlqim të zonjës Ledjana Shkurti prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, në zyrën e prokurorisë Tiranë votuan "pro" anëtarët: Bogdani, Stojani, Duda, Eminaaj dhe Merkuri. Votuan "kundër" Germenji, Mandro, Riza, Staka dhe Fejzulla. Në mungesë Hoda. Me votën përcaktuese të Kryetares miratohet propozimi i parashtruar, në zbatim të pikës 6 të nenit 166 të ligjit nr. 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*" i ndryshuar dhe pikës 7 të nenit 27 të Rregullores "*Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë*", të cilat përcaktojnë se "*Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit është përcaktuese.*"

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Arta Mandro
kundër

ANËTAR
Ledina Riza
kundër

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka
kundër

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla
kundër